



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4388/11 Prot.

Tiranë, më 09.07. 2024

URDHËR

NR. 350, DATË 09.07.

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER  
PROFESIONAL NË “MËSUESI E GJUHËS TURKE”, NË UNIVERSITETIN E NEW  
YORK-UT NË TIRANË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Mësuesi e gjuhës turke”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, angleze dhe turke, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 72MP0114SAX.  
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master profesional” në “Mësuesi e gjuhës turke”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Mësuesi e gjuhës turke”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut në Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ANA KAPAJ**



Konceptoi:	A. Gjini
Miratuan:	B. Biçoku V. Koçi
Konfirmuan:	J. Çollaku E. Tola
Data e shkresës tek SP:	__7.2024
Nr. i kopjeve të shkresës:	5